



Njohja e kompetencës ndërkulturore

Çka tregon se jam kompetent në aspektin ndërkulturor?

The Pestalozzi Programme
European Wergeland Centre
Intercultural Cities Programme

For further reading

Council of Europe (2008), White paper on intercultural dialogue: “living together as equals in dignity”

UNESCO (2007), *UNESCO Guidelines on intercultural education*, Paris.

European Commission (2007) on *a European agenda for culture in a globalizing world (Communication from the commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions)*

Çka tregon se jam kompetent në aspektin ndërkulturor?

Për dekada ka qenë e pranuar se të jesh kompetent në aspektin ndërkulturor është esenciale për bashkëjetesë në një botë të larmishme. Një numër i madh i dokumenteve të politikave, i publikimeve dhe i rekomandimeve nga organizata ndërkombëtare, sikur “The White Paper on Intercultural Dialogue” (Këshilli i Evropës, 2008) po ashtu e kanë shprehur shumë qartë këtë nevojë. Kompetenca ndërkulturore është kompetencë kryesore mbi të cilën duhet të punojë secili individ për të zhvilluar dhe mirëmbajtur shoqëritë e qëndrueshme demokratike. Me këtë mjet dëshirojmë t’ju ndihmojmë në mënyrë që të njihni më mirë vetveten në kontekst të diversitetit.

Në vijim, komponentët kryesorë të cilët formojnë kompetencën ndërkulturore – qëndrimet, shkathtësitë dhe njohuritë – janë të përshkruara në formë të deklaratave me “Unë” që përshkruajnë sjelljet e vëzhgueshme të cilat mund të lidhen me aspekte specifike të komponentëve. Natyrisht, komponentët janë të ndërlidhur pasi që njohuritë që kemi për botën dhe për ndërveprimin njerëzor, sikurse edhe qëndrimet tona për këto, mund të bëhen të dukshme dhe të vëzhgueshme vetëm përmes sjelljeve tona. Për më tepër, zhvillimi i shkathtësive dhe përfitimi i njohurive mund të rrisin kompetencën ndërkulturore vetëm nëse kemi qëndrime të drejta dhe nëse përdorim si duhet njohuritë dhe shkathtësitë e përfituara. Pikërisht për këtë arsye, pra për shkak të rëndësisë së qëndrimeve, nën-komponentët e qëndrimeve e tejkalojnë numrin e atyre të shkathtësive dhe njohurive, që përshkruhen në listën tonë të treguesve.

Mjeti në vijim është krijuar nga një grup prej 30 mësimeve, drejtorëve të shkollave dhe ekspertëve nga e gjithë Evropa në një punëtori studimore treditore duke u mbështetur në ekspertizën e përbashkët të pjesëmarrësve dhe rezultatet e vonshme të hulumtimeve dhe punës me projekte brenda Këshillit të Evropës dhe organizatave tjera ndërkombëtare. Kjo punë u organizua nga Programi Pestaloci dhe projekti i Qyteteve Ndërkulturore, si dhe Qendra Evropiane Wergeland. Mjeti u testua me 50 mësime dhe drejtorë në 14 vende, pastaj u finalizua duke marrë parasysh informatat kthyesë që u morën gjatë periudhës testuese.

Çka tregon se jeni kompetent në aspektin ndërkulturor? Mjeti është i menduar që t’ju ndihmojë të shikoni në vetvete, në kompetencën tuaj ndërkulturore dhe të njihni anët tuaja të forta, ashtu sikur se edhe fushat që kërkojnë zhvillim të mëtejshëm. Kur t’i keni 20-30 minuta të qetë, uluni dhe reflektoni për deklaratat me “unë” që përshkruajnë sjelljet e vëzhgueshme. Mendoni për veten nga konteksti i njerëzve të cilët ju rrethojnë, njerëzve që janë të afërm ose aspak të afërm, njerëzve me prejardhje të ndryshme socio-kulturore, rajonale, socio-ekonomike apo gjuhësore. Kujtoni përplasjet ndërkulturore që keni pasur apo për çfarëdo situata ku përfshiheshin të tjerët. Mundohuni të kujtoni si jeni ndjerë, çka keni ditur dhe çka keni bërë, dhe vini shenjën në katrorin e duhur pranë secilës deklaratë. Mund të përdorni mjetin individualisht ose mund ta përdorni në grup me kolegët e juaj. Kur të keni mbaruar, me gjasë do të jetë koha të reflektoni për hapat që mund të ndërmerreni në ndihmë të zhvillimit tuaj. Ju mund t’i ktheheni mjetit në çfarëdo kohe dhe të shkoni nëpër të tërin apo nëpër pjesë të tij sërish, për të parë se çfarë ka ndryshuar.

Shpresojmë se ky mjet do të kontribuojë në një përvojë mësimore ngacmuese dhe të çmueshme!

Qëndrimet

1 – kurrë; 2 - rrallë; 3 - nganjëherë; 4 - shpesh; 5 - gjithmonë	1	2	3	4	5
1. Respekti					
Unë tregoj respekt ndaj personit tjetër si një qenie njerëzore e barabartë.					
Unë u ofroj të tjerëve hapësirë që të shprehën, si dhe i dëgjoj dhe reagoj në argumentet e tyre.					
Unë i shmangem gjykimin të bazuar në përshtypjen e parë.					
2. Toleranca e dykuptimisë					
Unë jam i/e përgatitur t'i lë anash përkohësisht vlerat dhe standardet e mia.					
Unë shfaq durim kur ballafaqohem me atë që është e panjohur.					
Unë ndërveproj pozitivisht pa e ditur me siguri se çka mendon dhe ndjen tjetri bashkëbiseduesi/tjetri.					
Unë shfaq vetëdijen për faktin që mënyra ime e të menduarit dhe e të vepruarit është e ndikuar nga një strukturë e vlerave dhe normave					
3. Mendjehapësia dhe kureshtja					
Unë tregoj interes miqësor ndaj njerëzve dhe gjërave që i ndesh.					
Unë i shfrytëzoj mundësitë që më shfaqen për të takuar njerëz të rinj.					
Unë i pyes të tjerët për pikëpamjet dhe veprimet e tyre.					
4. Ndjeshmëria					
Unë jam i gatshëm të tregoj vëmendje për ndjenjat e të tjerëve.					
Unë e dëshmoj që mund të marr pjesë në ndjenjat e të tjerëve.					
5. Vetëdija					
Unë tregoj se ndihem rehat me përshkrimin e anëve e mia të forta dhe dobësive.					
Unë e pranoj faktin që mund të bëj gabime.					
Unë marr përgjegjësi për gabimet e mia.					
Unë kërkoj ndihmë prej të tjerëve, kur më duhet.					
Unë e përshtat sjelljen time kur ndjej se kjo është e dobishme.					
6. Siguria për të sfiduar dhe për të qenë i sfiduar					
Unë tregoj se nuk frikohem të shfaq mospajtim me të tjerët.					
Unë sugjeroj mënyra alternative për t'i parë e për t'i bërë gjërat.					
Unë tregoj se pranoj të jem i/e sfiduar.					

Shkathësitë

1 – kurrë; 2 - rrallë; 3 - nganjëherë; 4 - shpesh; 5 - gjithmonë	1	2	3	4	5
1. Ndërveprimi					
Unë i dëgjoj me kujdes njerëzit tjerë.					
Unë sigurohem që porosia ime të kuptohet ashtu siç e mendoj					
Unë i inkurajoj njerëzit të shprehin nevojat dhe pikëpamjet e tyre lirshëm.					
Unë reagoj me përkrahje ndaj emocioneve që i shoh përreth.					
Unë i kërkoj dhe i qartësoj nevojat dhe pritjet e përbashkëta.					
2. Perspektivat e shumëfishta					
Unë kërkoj informata nga shumë burime.					
Unë i shpjegoj mendimet dhe veprimet e mia duke i marrë parasysh edhe pikëpamjet që vijnë nga jashtë.					
Unë e shpreh pikëpamjen time në raport si me pikëpamjet e kundërta ashtu edhe me ato plotësuese.					
Unë e përdor imagjinatën time për të ofruar pikëpamje të ndryshme.					

1 – kurrë; 2 - rrallë; 3 - nganjëherë; 4 - shpesh; 5 - gjithmonë	1	2	3	4	5
3. Të menduarit kritik					
Unë i përdori të gjitha informatat që i kam në dispozicion si dhe shkathtësitë e mia analitike që ta vërtetoj interpretimin tim.					
Unë vë në pikëpyetje interpretimet e ofruara nga të tjerët duke përfshirë figurat me autoritet dhe burimet me autoritet.					
Unë ofroj mënyra të ndryshme për të interpretuar idetë dhe veprimet e njerëzve.					
Unë jap argumente të qarta që të shpjegoj mendimet dhe vendimet e mia.					

4 Zgjedhja e problemit dhe bashkëpunimi					
Unë i identifikoj çështjet apo problemet që duhet të zgjidhen.					
Unë ofroj perspektiva të ndryshme për problemin që duhet zgjidhur.					
Unë nis përpjekjet për të zgjidhur problemin.					
Unë i përkrah përpjekjet e njerëzve të tjerë për të zgjidhur problemin.					
Unë aktivisht kërkoj zgjidhje së bashku me njerëzit e tjerë të interesuar.					
Unë i bëj të tjerët të ndjehen rehat në grup kur ballafaqohen me ndonjë problem.					

5 Aftësia për t'u zhvilluar					
Unë hulumtoj gjëra dhe situata të reja.					
Unë i shqyrtoj dhe i analizoj motivet, nevojat dhe qëllimet e mia.					
Unë e ndryshoj mënyrën se si i bëj gjërat, në frymën e risive.					

Njohuria

1 – kurrë; 2 - rrallë; 3 - nganjëherë; 4 - shpesh; 5 - gjithmonë	1	2	3	4	5
1. Njohuria për ndërveprimin					
Unë marr parasysh si porositi verbale ashtu edhe ato jo verbale.					
Unë jam i vetëdijshëm se fjalët dhe "gjuha e trupit" mund të kenë kuptime të ndryshme në situata të ndryshme.					
Unë i qartësoj kuptimet për t'i shmangur keqkuptimet.					
Unë e adresoj ndikimin e raporteve të pushtetit në ndërveprim.					
Unë demonstrtoj se e kuptoj që format e ndryshme të ndërveprimit kanë qëllime dhe rregulla të ndryshme					

2. Njohuritë për praktikat shoqërore					
Unë jam i vetëdijshëm për faktin se njerëzit tjerë mund të mendojnë, të sillen dhe të ndjehen ndryshe					
Unë aktivisht i hulumtoj arsyet që qëndrojnë prapa praktikave dhe reagimeve të ndryshme					

3. Njohuritë për rolin e aktorëve socialë dhe politikë (individë ose institucione)					
Unë i dalloj implikimet sociale dhe politike të diversitetit.					
Unë iu drejtohem aktorëve adekuatë socialë, kulturorë apo politikë kur kam nevojë për informacion ose mbështetje.					
Unë inicioj bashkëpunim me grupin adekuat të aktorëve socialë apo politikë kur një problem shfaqet.					

4. Njohuritë për botëkuptimet dhe sistemet e të besuarit					
Unë besoj së çështjet shpirtërore dhe ekzistenciale janë aspekte të rëndësishme jetësore.					
Unë i dalloj ndryshimet në botëkuptime dhe sisteme të të besuarit kur ndërveproj.					
Unë mësoj për sistemet tjera të të besuarit dhe për botëkuptimet, duke hulumtuar në mënyrë aktive.					
Unë tregoj mirëkuptim për faktin që botëkuptimet dhe besimet që njerëzit kanë nuk janë statike.					
Unë e pranoj që botëkuptimet dhe sistemet e të besuarit kanë ndikim, por nuk e përcaktojnë identitetin e një personi ose të një grupi.					

E tani? Ku qëndroj unë? Kah të shkoj?